



UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË

Kryesues i KQZ-së  
Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Nr. Prot. 933 Dt 26.04.2023

Në bazë të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, dhe Planit Dinamik të zgjedhjeve të Studentëve, Komisioni Qendror Zgjedhor, në mbledhjen e mbajtur më 26.04.2023, mori:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OS "Zëri Studentor" nr. protokoli 925 e datës 25.04.2023, kundër vendimit të KQZ-së për certifikimin e Organizatave Studentore.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KQZ-së me nr. protokoli 919 i datës 25.04.2023.

**A r s y e t i m**

Komisioni Qendror Zgjedhor, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.04.2023 shqyrtoj ankesën me nr. 925 të datës 25.04.2023 të bërë nga Organizata Studentore "Zëri Studentor", dhe në mënyrë unanime u vendos që kjo ankesë të refuzohet si e pa bazë. Ky vendim është marrë duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, ku në mënyrë taksative thuhet: *"Në rast se konstatohen parregullsi ose falsifikim me rastin e plotësimit të shenimeve në listat mbështetëse, Komisioni Qendror Zgjedhor, largon nga lista mbështetëse emrin e kandidatit/es i cili gjendet edhe në lista të tjera dhe merren masa ligjore kundër tij/saj në pajtim me legjislacionin në fuqi"*, dhe duke u bazuar në nënshkrimet e studenteve në listat mbështetëse të OS të cilat kanë qenë nën minimumin e lejuar për certifikim sipas nenit 8, paragrafi 6 të Rregullores së lartëcekur, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Organizatat studentore mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi, pranë Këshillit Drejtues të UIBM, në afat prej 24 orësh nga publikimi i këtij vendimi.

Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Kryesues i KQZ-së

